



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 3716 Prot

Shkodër, më 09 . 11 .2025

Lënda: Publikim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"- Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës për një vend të lirë pune. Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI

Prof. dr. Tomir Gurraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 376 Prot

Shkodër, më 04 . 11 .2025

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf ndihmës-akademik pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore, Departamenti i Biologji-kimisë, në pozicionin laborant/e me kohë të plotë.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në sistemin me kohë të plotë në fushën e "Biologjisë". Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, e noterizuar.
2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 6 (Bachelor/Program studimi i nivelit të parë), duhet të jetë jo më e ulët se 7.5 (shtatë pikë pesë), kurse nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet duhet të jetë jo më e ulët se 8 (tetë).
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Program studimi i nivelit të dytë, Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar) duhet të jetë jo më e ulët se 7.5 (shtatë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet duhet të jetë jo më e ulët se 8 (tetë).
4. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, me nivel jo më të ulët se B1 (notë jo më të ulët se shtatë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
5. Preferohet që kandidatët të kenë :
 - 5/1. përvojë pune në laborator,
 - 5/2. kryer specializime, trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse,
 - 5/3. aftësi shumë të mira komunikimi dhe pune në grup,
 - 5/4. aftësi të mira kompjuterike.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.



5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor.
7. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje **familjare** (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), **gjinie** (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë ku kërkojnë të punësohen si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Kërkesë me shkrim për punësim në USH,
2. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse.
4. Kopje e noterizuar e dëshmime të kualifikimeve të ndryshme pasuniversitare.
5. Rekomandim ose letër referencë nga punëdhënësi i fundit.
6. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose kopje e noterizuar.
7. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbartimit).
8. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë).
9. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (kopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
10. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore dhe/ose konflikt interesi).
11. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
12. Vërtetim rajoni për adresën/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar konform nenit 37 të Rregullores.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik. (me shënimin "Për konkursin e laborantit të Departamentit të Biologji-kimisë")
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë njësi bazë përkatëse.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

REKTORI

Prof. dr. Tahir GJERAJ

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, , <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al

